



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 41, datë 31.03.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT**  
**“ATLANTIK – SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike të shoqërisë “Atlantik– shoqëri sigurimesh” sh.a., siç paraqiten në 31 dhjetor 2022, sipas përlogaritjes së shoqërisë.**
- Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2022 të provigjoneve teknike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:**

<b>Provigjonet teknike në 31 dhjetor 2022</b>	<b>Lekë</b>
<b>Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total</b>	<b>1,019,912,199</b>
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	13,437,979
<b>Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total</b>	<b>1,006,474,220</b>

- Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**